



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbim

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

**“Shërbime me sistem ndriçimi, audio, ledwalle, struktura dhe suport teknik për
nevoja të realizimit të eventeve”**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

79952000-2 - Shërbime të organizimit të eventeve;

VLERA E FONDIT LIMIT:

3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Drejtoria e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

c. *Formulari i ofertës ekonomike sipas Shtojcës 1;*

d. *Lista e çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit sipas Shtojcës 2;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:**

Referuar pikës 1 të shtojcës 9, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 10.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. **Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën, duhet të paraqesin vërtetim të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik për vitet financiare (2021, 2022, 2023) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e vogël se 40% të vlerës së parashikuar e kontratës që prokurohet. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri

... vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;”. Kjo procedurë është nën kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 2/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse vlera e xhiros minimale për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, është jo më e vogël se 40% e vlerës së parashikuar të kontratës. Në çdo rast, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 55, pika 4 gërma (b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të

vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohej, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Për arsye se shërbimet janë specifike, kërkohej eksperiencë e ngjashme në realizimin e këtyre shtërbimeve, për të siguruar Autoritetin Kontraktor për përmbushjen me sukses të kësaj procedure.

- 2.3.2.** Operatori ekonomik për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave duhet të ketë të punësuar minimalisht 5 (pesë) punonjës, vërtetuar me listëpagesën e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes se ofertave;

***Shënim:** Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

- 2.3.3.** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar ose me kontratë angazhimi / bashkëpunimi punonjësit e mëposhtëm:

- 1 fotograf, për fotografimin e eventeve me cilësi të lartë;
- 1 videograf/kameraman për filmime profesionale me cilësi të lartë lartë përfshirë dhe filmimin me dron;
- 1 video editor për përpunimin audio dhe video të filmimeve;
- 1 menaxher eventit për implementimin dhe monitorimin e eventit;
- 1 teknik audio për fonin e eventit;
- 1 DJ;
- Grup me 5 animatorë (klloun, xhongelier, këmbëgjatë, maskota të ndryshme dhe persona që realizojnë face painting).

Për punonjësit e mësipërm, ofertuesi duhet të paraqesë:

- CV;

- Kontratë individuale të punës ose shërbimit të vlefshme për të gjithë kohëzgjatjen e kësaj kontrate;
- Listëpagesa e shoqërisë minimumi për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave për punonjësit e siguruar nga operatori ekonomik;

Shënim: Ky kriter do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9, të DST. Të plotësohet formulari përmbledhës i vetëdeklarimit me të dhënat e detajuara për secilin punonjës (emër, mbiemër, detyra që do të realizojë, me kontratë pune apo shërbimi).

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të Njoftimit të Fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, neni 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe gërma b, pika 4, neni 41 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat e shërbimeve, me afatin e zbatimit të realizimit të shërbimit.

Bazuar në termat e referencës të realizimit të shërbimit dhe kërkesat e paraqitura secili nga punonjësit e kërkuar do të realizojë shërbimet e kërkuara duke i siguruar Autoritetit Kontraktor përmbushjen me sukses të kësaj procedure.

Punonjësi fotograf do të realizojë shërbimin e fotografimit.

Punonjësi videograf/kameraman do të realizojë shërbimin e videografimit/filmimit.

Punonjësi video editor do të realizojë shërbimin e montazhit/përpunimit të video/foto.

Punonjësi menaxher eventit do të ndjeki implementimin dhe monitorimin e eventit

Punonjësi teknik audio do të realizojë shërbimin për fonin e eventeve.

Punonjësi DJ të realizojë shërbimin e DJ (muzika gjatë eventeve).

Grup me 5 animatorë (klloun, xhongelier, këmbëgjatë, maskota të ndryshme dhe persona që realizojnë face painting) do të realizojnë animacionet dhe lojrat me fëmijët gjatë eventeve që do të realizohen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara, të përkthyer dhe të noterizuara, nëse janë në gjuhë të huaj.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Rruga “Liqeni i Thatë”, Tiranë, Shqipëri

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Termet e referencës janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Titullarit të Autoritetit Kontraktor nr. 254, datë 15.10.2024 “Për ngritjen e grupit të punës për përcaktimin e termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës me objekt: “Shërbime me sistem ndriçimi, audio, ledwalle, struktura dhe suport teknik për nevoja të realizimit të eventeve”, protokolluar me nr. 493/1 prot., datë 15.10.2024, i cili ka hartuar procesverbalin nr. 493/2 prot., datë 15.10.2024 “Për përcaktimin e termave të referencës në procedurën e prokurimit me objekt: “ Shërbime me sistem ndriçimi, audio, ledwalle, struktura dhe suport teknik për nevoja të realizimit të eventeve”. (gjenden në shtojcën 8 në DST).

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimitisht miratimin e dokumenteve të tenderit. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt **“Shërbime me sistem ndriçimi, audio, ledwalle, struktura dhe suport teknik për nevoja të realizimit të eventeve”**, Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurim Znj. Ilva Ymeraj.

Njësia e Prokurimit: